



**AMBASADA E GREQISË
TIRANË**

**FTESË / SHPREHJE INTERESI
PER FURNIZIMIN E PORTËS ELEKTRONIKE DETEKTUESE TË METALEVE**

Ambasada e Greqisë në Tiranë fton shoqëritë SECTRON SH.P.K. dhe AESS SH.P.K. në Shqipëri, të cilat ushtrojnë aktivitet në objektin e kësaj shkrese dhe dëshirojnë të paraqesin oferta për furnizimin e një (1) porte elektronike të zbulimit të metaleve për hyrjen e Ambasadës, me kosto totale deri në shumën 4.300,00 euro (pa TVSH) dhe kriter ofertën më të favorshme bazuar në çmimin dhe aftësitë e ofruara.

Kjo ftesë është subjekt i termave dhe kushteve të mëposhtme:

1. **OBJEKTI I FTESËS.** Objekti i kësaj ftese është furnizimi me një (1) portë elektronike për zbulimin e metaleve për hyrjen e Ambasadës, me kosto totale deri në shumën 4.300,00 Euro (pa TVSH).

Kriteret e furnizimit: Oferta më e favorshme nga pikëpamja financiare dhe shërbimet e ofruara.

2. **PËRGATITJA E OFERTAVE.** Ofertat dërgohen me shkrim në Ambasadën e Greqisë në Tiranë ose në mënyrë elektronike në adresën e e-mailit të Ambasadës së Greqisë në Tiranë gremb.tir@mfa.gr në greqisht, shqip ose anglisht.

3. **DOKUMENTACIONI PËR PJESËMARRJE.** Nga pjesëmarrësit kërkohet që, nëse ftohen për të kryer furnizimin, të paraqesin: Vërtetim për mos patje të detyrimeve tatimore dhe të sigurimeve, dëshmi penaliteti dhe një certifikatë/vërtetim përfaqësimi të shoqërisë.

4. **OFERTA FINANCIARE.** Oferta financiare e kandidatëve do të përfshijë shumat në Lek dhe Euro (me dhe pa TVSH). Në rast se çmimi i ofruar pa TVSH tejkalon buxhetin, oferta e pjesëmarrësit do të refuzohet.

5. **PROCEDURA E VLERËSIMIT.** Ofertat do të vlerësohen nëse janë të plota dhe do të zgjidhet ajo më e favorshme.

6. **PAGESA.** Pagesa e kontraktorit do të bëhet me transfertë bankare nga Ambasada e Greqisë në Tiranë.

Shuma totale mund të paguhet menjëherë pas dorëzimit/instalimit/provës së funksionimit dhe lëshimit të dokumentit ligjor përkatës.

Nga ana e Ambasadës mund të merret në konsideratë një pagesë paraprake prej 50% e shumës me porosinë e kryer dhe pagesa 50% e mbetur pas dorëzimit.

7. **BUXHETI.** Buxheti është katër mijë e treqind euro (4.300,00€), çmim pa TVSH.

8. **DORËZIMI I OFERTËS.** Të interesuarit mund të paraqesin ofertën e tyre me shkrim ose ta dërgojnë në adresën e e-mailit gremb.tir@mfa.gr deri në datë 03.06.2024, e Hënë ora 12:00, në Ambasadën e Greqisë në Tiranë.

Ofertat angazhojnë kandidatët derisa tu caktohet furnizimi i kërkuar dhe ta përfundojnë atë.

9. **KOHA E DORËZIMIT.** Dorëzimi duhet të kryhet brenda pesë (5) javësh nga njoftimi me shkrim/elektronik i dhënies së kontraktimit nga Ambasada e Greqisë në Tiranë.

Kjo Ftesë për Shprehje Interesi do të publikohet në K.H.M.D.H.S dhe në faqen e internetit të Ambasadës së Greqisë në Tiranë në adresën: <https://www.mfa.gr/albania/presveia/>.
Të interesuarit mund të marrin informacion mbi ecurinë e procesit të prokurimit në numrat e kontaktit të Ambasadës së Greqisë në Tiranë.



Tiranë, 27/05/2024

Kamitsi
Ambasadorja
Konstantina Kamitsi
Ministër Fuqplotë A